



## **KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh. A.**

Metodologjia e Përcaktimit të Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar

Prill 2014

## Përmbajtja

HYRJE.....	3
KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....	5
Qëllimi dhe fushëveprimi.....	5
Përkufizimet dhe interpretimet .....	5
KREU II PARIMET E NGARKESAVE .....	7
Dizajni i ngarkesave.....	7
Niveli i ngarkesave .....	7
KREU III TË DHËNAT HYRËSE DHE ALOKIMI .....	8
Të dhënat për llogaritjen e ngarkesave .....	8
Kostot Variable.....	8
Kostot Fikse .....	10
KREU IV NGARKESAT E APLIKUARA NGA GJENERATORI .....	11
Llogaritja e Ngarkesës për Energji.....	11
Llogaritja e Ngarkesës për Kapacitet.....	11
KREU V PËRCAKTIMI I NGARKESAVE TË RREGULLUARA .....	13
Përcaktimi i ngarkesës për Energji dhe Kapacitet.....	13
SHTOJCA 1: Diagrami rrjedhës i llogaritjes së Ngarkesave të Rregulluara.....	14
SHTOJCA 2: Tabela e përcaktimit të ngarkesës për kapacitet për Gjeneratorët e Rregulluar.....	15

## HYRJE

Të Hyrat Maksimale të Lejuara në një Vit të Caktuar Relevant do të mblidhen përmes Ngarkesave të Rregulluara që përcaktohen sipas Metodologjisë së Përcaktimit të Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar, e përshkruar në detaje në këtë dokument.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Termocentrali Kosova A dhe Termocentrali Kosova B duke pasur parasysh që ishin gjeneratorë në operim në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit për Energjinë Elektrike, dhe në përputhje me Rregullin për Vendosjen e Çmimeve për Gjenerimin si dhe në përputhje me Parimet për Vendosjen e Ngarkesave të Gjeneratorit të Rregulluar, janë të obliguar të hartojnë Metodologjinë, duke përcaktuar tarifat/ngarkesat e rregulluara për prodhimin e energjisë elektrike e cila i shitet furnizuesit publik.

Metodologjia duhet të reflektojë parimet e përgjithshme në vijim:

- Të Hyrat Maksimale të Lejuara në një vit të caktuar relevant duhet të ndahen në Kosto Fikse dhe në Kosto Variabile sipas udhëzimeve të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar (Neni 14) dhe Parimeve për Vendosjen e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar (Neni 7);
- Kostot fikse do të jenë ato kosto të gjeneratorëve të rregulluar të cilat nuk ndryshojnë me nivelin e prodhimit. Këto kosto, në parim, do të përfshijnë kostot e zhvlerësimit dhe kthimit të lejuar në çdo Vit Relevant si dhe komponentin fikse të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes.
- Kostot variabile do të përfshijnë ato kosto që nuk do të ndodhnin sikur niveli i prodhimit në një Vit të caktuar Relevant të ishte zero.
- Kostot fikse do të mbulohen përmes aplikimit të Ngarkesës për Kapacitet e cila do t'i aplikohet çdo ore të kapacitetit në dispozicion të Gjeneratorit të Rregulluar. Orët në dispozicion do të caktohen nga Caku i Disponibilitetit i cili do të caktohet për çdo vit nga Rregullatori. Në parim ky cak do të paraqesë sa orë në vit duhet të jetë gjeneratori në dispozicion në mënyrë që të mbulojë të Hyrat Maksimale të Lejuara për Vitin Relevant. Faktori i Disponibilitetit duhet të marrë parasysh performancën e viteve të kaluara, performancën e pritshme si dhe nivelin e këtij faktori për gjeneratorët e tjerë në nivel ndërkombëtar, si dhe programin e planifikuar të mirëmbajtjes të njesive gjeneruese për ndalesat e detyruara.
- Kostot variabile do të mbulohen përmes Ngarkesës për Energji e cila do të aplikohet për çdo njësi të matur (MWh) të energjisë së prodhuar nga Gjeneratori i Rregulluar. Niveli i parashikuar i prodhimit të energjisë elektrike do të jetë ai nivel i cili përdoret nga Zyra e Rregullatorit për Energji në llogaritjen e MAR të Gjeneratorit të Rregulluar.
- Gjeneratori i Rregulluar do të ketë të drejtë të përcaktojë Ngarkesat për Kapacitet sipas Nenit 17.3 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjenerimit, përderisa ato reflektojnë Nenin 16 të asaj Rregulle dhe aprovohen nga ZRRE.

- Gjeneratori i Rregulluar do të ketë të drejtë të përcaktojë Ngarkesat për Energji sipas Nenit 19.2 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjenerimit përderisa ato reflektojnë Nenin 18 të asaj Rregulle dhe aprovohen nga ZRRE.

Andaj, bazuar në kërkesën e paraqitur në Nenin 16 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 19 paragrafi 1 të Rregullës për Vendorsjen e Çmimeve të Gjenerimit e miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji si dhe bazuar në Parimet për Vendorsjen e Ngarkesave të Gjeneratorit të Rregulluar e miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. harton Metodologjinë e Përcaktimit të Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar (tutje: Metodologjia):

# Metodologjia e Përcaktimit të Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar

## KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Qëllimi dhe fushëveprimi

- 1 Qëllimi i Metodologjisë është paraqitja e llogaritjes së ngarkesave për energji dhe ngarkesave për kapacitet në pajtim me kërkesat e përshkruara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Rregullin për Vënien e Çmimeve të Gjenerimit dhe me Parimet për Vendosjen e Ngarkesave të Gjeneratorit të Rregulluar.

### Përkufizimet dhe interpretimet

- 2 Shprehjet e përdorura në këtë Metodologji kanë këtë kuptim:
  - 2.1 “Ngarkesë për Kapacitet” nënkupton ngarkesën për njësi të kapacitetit në dispozicion, që përdoret për mbulimin e Kostove Fikse të Gjeneratorit të Rregulluar, të definuar sipas Llogaritjes së Ngarkesës për Kapacitet në këtë Metodologji;
  - 2.2 “Ngarkesë për Energji” nënkupton ngarkesën për Njësi të Furnizuar të energjisë elektrike që përdoret për të mbuluar Kostot Variabile të Gjeneratorit të Rregulluar, të definuar sipas Llogaritjes së Ngarkesës për Energji në këtë Metodologji;
  - 2.3 “Kosto fikse” nënkupton kostot që nuk ndryshojnë me ndryshimin e nivelit të prodhimit, të definuar në përshkrimin e Kostos Fikse në këtë Metodologji;
  - 2.4 “Kosto variabile” nënkupton ndryshimin në mes të kostove totale dhe kostove fikse, të definuar në përshkrimin e Kostos Variabile në këtë Metodologji;
  - 2.5 “Të Hyrat Maksimale të Lejuara” nënkupton të hyrat e përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji, e që duhet të mbulohen me aplikimin e Ngarkesave të Rregulluara;
  - 2.6 “Vit Relevant” nënkupton 12 muaj kalendarik në mes të Përshtatjeve të Rregullta brenda të cilit Gjeneratori i Rregulluar duhet të mbulojë të Hyrat Maksimale të Lejuara;
  - 2.7 “Gjenerator i Rregulluar” nënkupton Gjeneratorin e definuar sipas Nenit 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Nenit 2 nën-paragrafi 1.33 të Rregullit për Vendosjen e Çmimeve të Gjenerimit;

- 2.8 “Njësi e Furnizuar” nënkupton një MWh;
- 2.9 “Kapaciteti në Dispozicion” nënkupton kapacitetin e Gjeneratorit të Rregulluar që është në dispozicion për furnizim;
- 2.10 “Caku i Disponibilitetit” nënkupton cakun e Kapacitetit në Dispozicion brenda një viti, që përshtatet për të reflektuar nivelin e mirëmbajtjes, daljet e detyrueshme jashtë funksionit si dhe arsyet e tjera të daljes nga dispozicioni.
- 2.11 “Parimet për Vendosjen e Ngarkesave të Gjeneratorëve të Rregulluar” nënkupton dokumentin e miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji ku përshkruhen parimet sipas të cilave duhet të llogariten Ngarkesa për Kapacitet dhe Ngarkesa për Energji e Gjeneratorit të Rregulluar;
- 2.12 Të gjithë termat tjerë që nuk janë përkufizuar me këtë Metodologji do të kenë kuptimin e njëjtë me termat e përdorur në Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë, Rregullën për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar dhe në Parimet për Llogaritjen e Ngarkesave të Gjeneratorit të Rregulluar.

**KREU II**  
**PARIMET E NGARKESAVE**

**Dizajni i ngarkesave**

- 1 Ngarkesat e aplikuara nga Gjeneratori i Rregulluar do të jenë Ngarkesa për Energji dhe Ngarkesa për Kapacitet.
- 2 Llogaritja e Ngarkesave të aplikuara nga Gjeneratori i Rregulluar do të marrin parasysh të Hyrat Maksimale të Lejuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji gjatë Shqyrtimeve Periodike dhe të përshtatura gjatë Përshtatjeve të Rregullta në mes të çdo Viti Relevant.
- 3 Ngarkesat e aplikuara duhet të jenë të thjeshta, transparente dhe duhet të marrin parasysh zhvillimet e ardhshme në sektorin e energjisë elektrike.

**Niveli i ngarkesave**

- 1 Ngarkesa për Energji do të caktohet në atë nivel, ashtu që përmes saj të mbulohet komponenta e Kostove Variabile e të Hyrave të Lejuara Maksimale për Vitin Relevant.
- 2 Ngarkesa për Kapacitet do të caktohet në atë nivel, ashtu që përmes saj të mbulohet komponenta e Kostove Fikse e të Hyrave të Lejuara Maksimale për Vitin Relevant.

**KREU III**  
**TË DHËNAT HYRËSE DHE ALOKIMI**

**Të dhënat për përcaktimin e ngarkesave për vitin relevant**

- 1 Llogaritja e Ngarkesave të Gjeneratorit do të bazohet në të dhënat e matshme, të sakta dhe të verifikueshme.
- 2 Në llogaritjen e Ngarkesave të Gjeneratorit të Rregulluar do të merren parasysh të dhënat në vijim:
  - 2.1 Të Hyrat Maksimale të Lejuara për Gjeneratorin e Rregulluar që llogariten në bazë të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar dhe që janë të vlefshme për Vitin Relevant;
  - 2.2 Komponentën e Kostove Variabile dhe asaj të Kostove Fikse të të Hyrave Maksimale të Lejuara;
  - 2.3 Balancën e Energjisë Elektrike të aplikuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji nëpër llogaritjen e të Hyrave Maksimale të Lejuara të Gjeneratorit të Rregulluar; dhe
  - 2.4 Faktorin e Disponibilitetit që propozohet nga Gjeneratori i Rregulluar dhe aprovohet nga Zyra e Rregullatorit për Energji dhe i cili përdoret për llogaritjen e Ngarkesës për Kapacitet;

**Kostot Variabile**

- 1 Në çdo Vit Relevant, Të Hyrat Maksimale të Lejuara do të alokohen në Kosto Fikse dhe Kosto Variabile.
- 2 Kostot Variabile janë ato Kosto niveli i të cilave ndryshon me nivelin e prodhimit dhe përfshinë komponentën variabile të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes;
- 3 Komponenta variabile e kostove të furnizimit me thëngjill do të llogaritet në këtë mënyrë:
  - 3.1 Në rast se ekziston marrëveshja e furnizimit me thëngjill, komponenta variabile e kostove të furnizimit me thëngjill do të jetë e barabartë me ngarkesën variabile në atë marrëveshje;
  - 3.2 Në rast se nuk ekziston marrëveshja e furnizimit me thëngjill, komponenta variabile e kostove të furnizimit me thëngjill do të marrë parasysh kostot që nuk do të shkaktoheshin sikur niveli i prodhimit të thëngjillit në një Vit të caktuar Relevant të ishte zero.



- 4 Komponenta Variabile e kostove (VCG)e të Hyrave të Lejuara Maksimale të Gjeneratorit të Rregulluar do të llogaritet sipas formulës:

$$VCG=CUT+CRM+CMS+CLU+OCT+VCM+FUC+PTC+LFC$$

*Ku*

<i>VCG</i>	<i>paraqet komponentën variabile të kostove të gjeneratorit</i>
<i>CUT</i>	<i>paraqet kostot e shërbimeve komunale dhe kostot e tjera që përdoren gjatë prodhimit të energjisë elektrike (ujë, energji elektrike etj.)</i>
<i>CRM</i>	<i>paraqet kostot e riparimeve të pajisjeve të dëmtuara dhe të mirëmbajtjes së pajisjeve të përdorura në prodhimin e energjisë elektrike</i>
<i>CMS</i>	<i>paraqet kostot e materialeve dhe furnizimeve</i>
<i>CLU</i>	<i>paraqet kostot e lubrifikimit të stabilimenteve energjetike</i>
<i>OCT</i>	<i>paraqet kostot e tjera që ndryshojnë me nivelin e prodhimit të energjisë elektrike</i>
<i>VCM</i>	<i>paraqet komponentën variabile të kostove të lejuara të minierës që do të llogariten si kostot që nuk do të ndodhnin sikur prodhimi i thëngjillit të ishte i barabartë me zero, të definuara sipas Nenit 6.4.2 të kësaj Metodologjie</i>
<i>FUC</i>	<i>paraqet kostot e karburanteve</i>
<i>PTC</i>	<i>paraqet kostot që barten OS dhe OT</i>
<i>LFC</i>	<i>paraqet pagesat e licencës</i>

- 4.1 Komponenta Variabile e Kostove të Lejuara të Furnizimit me Thëngjill (VCM) do të llogaritet bazuar në të njëjtat parime si Komponenta Variabile e të Hyrave të Lejuara të Gjeneratorit të Rregulluar.
- 4.2 VCM do të llogaritet sipas kostove që nuk do të ndodhnin sikur niveli i prodhimit të thëngjillit në një Vit të caktuar Relevant të ishte i barabartë me zero.

## Kostot Fikse

- 1 Komponenta e Kostove Fikse të Gjeneratorit të Rregulluar do të përfshijë të gjitha ato kosto që nuk varen nga niveli i prodhimit të Gjeneratorit.
- 2 Komponenta e Kostove Fikse (FCG) e të Hyrave të Lejuara Maksimale të Gjeneratorit të Rregulluar do të llogaritet sipas formulës:

$$FCG = PNC + INC + HQC + RTN + DEP + TPC + FMC$$

*Ku*

<i>FCG</i>	<i>paraqet komponentën fikse të kostove të gjeneratorit</i>
<i>PNC</i>	<i>paraqet kostot e stafit të kontraktuar që nuk ndryshon me nivelin e prodhimit të energjisë elektrike</i>
<i>INC</i>	<i>paraqet kostot e sigurimit shëndetësor</i>
<i>HQC</i>	<i>paraqet Kostot e Administratës qendrore</i>
<i>RTN</i>	<i>paraqet kthimin e lejuar në kapital</i>
<i>DEP</i>	<i>paraqet zhvlerësimin e lejuar</i>
<i>TPC</i>	<i>paraqet kostot e transportit të cilat nuk varen nga niveli i prodhimit</i>
<i>FMC</i>	<i>paraqet komponentën fikse të kostove të Minierës, të definuara në paragrafin 2.1 të këtij kreu</i>

- 2.1 Komponenta fikse e Kostove të Lejuara të Furnizimit me Thëngjill nuk mund të jetë më e madhe se ndryshimi në mes të totalit të kostove të lejuara të furnizimit me thëngjill dhe komponentës variabile të tyre.
- 2.2 Për shmangie të dyshimit, Kostot Variabile do të përfshijnë edhe kostot vjetore të rentës së linjitit.

**KREU IV**  
**NGARKESAT E APLIKUARA NGA GJENERATORI**

**Llogaritja e Ngarkesës për Energji**

- 1 Ngarkesa për Energji do të llogaritet në mënyrë që përmes saj të mbulohen Kostot Variabile të Gjeneratorit të Rregulluar, duke pasur parasysh që Gjeneratori i Rregulluar të arrijë njësitë e parashikuara të furnizimit në Vitin Relevant “t”.
- 2 Ngarkesa për Energji do të jetë herësi në mes të Kostove Variabile të definuara në Kreun III të kësaj Metodologjie (matur në euro) dhe nivelit të parashikuar të prodhimit të energjisë elektrike (matur në MWh)
- 3 Niveli i parashikuar i prodhimit të energjisë elektrike do të përcaktohet duke marrë parasysh mirëmbajtjet e pritshme të Gjeneratorit të Rregulluar gjatë vitit të ardhshëm Relevant si dhe numrin e arsyeshëm të orëve të daljeve të papritura të Gjeneratorit të Rregulluar nga funksioni.
- 4 Ngarkesa për Energji do të llogaritet sipas formulës:

$$NPE = \frac{VCG}{NF}$$

*Ku*

*NPE* paraqet Ngarkesën për Energji që do të përdoret për mbulimin e Komponentës Variabile të Gjeneratorit të Rregulluar

*VCG* paraqet Kostot Variabile të Gjeneratorit të Rregulluar, të definuara sipas Nenit 6 të kësaj Metodologjie

*NF* paraqet sasinë e furnizuar të energjisë elektrike neto<sup>1</sup> brenda një Viti Relevant (matur në MWh)

**Llogaritja e Ngarkesës për Kapacitet**

- 1 Ngarkesa për Kapacitet llogaritet në mënyrë që përmes saj të mbulohen Kostot Fikse të Gjeneratorit të Rregulluar, për disponibilitetin e caktuar nga ZRRE për Vitin Relevant “t”.
- 2 Ngarkesa për Kapacitet do të llogaritet sipas formulës:

---

<sup>1</sup> Energjia elektrike neto është e barabarte me energjinë totale minus konsumi nga gjeneratori.

$$NPK = \frac{FCG}{CID}$$

Ku

NPK paraqet Ngarkesën për Kapacitet që do të përdoret për mbulimin e Komponentës Fikse të Gjeneratorit të Rregulluar

FCG paraqet Kostot Fikse të Gjeneratorit të Rregulluar, të definuara sipas Kreut III të kësaj Metodologjie

CID paraqet Cakun e Disponibilitetit i cili do të caktohet nga Rregulatori në bazë të propozimit të Gjeneratorit të Rregulluar

3 Caku i Disponibilitetit do të llogaritet duke marrë parasysh:

3.1 Performancën e kaluar;

3.2 Performancën e parashikuar; dhe

3.3 Krahasimin me gjeneratorët e tjerë në Kosovë dhe në vende të tjera ndërkombëtare.

4 Caku i disponibilitetit do të përcaktohet duke marrë parasysh mirëmbajtjet e pritshme të Gjeneratorit të Rregulluar gjatë vitit të ardhshëm Relevant si dhe numrin e arsyeshëm të orëve të daljeve të papritura të Gjeneratorit të Rregulluar nga funksioni.

5 Caku i disponibilitetit të Gjeneratorëve të Rregulluar do të përcaktohet si shuma e caceve të disponibilitetit të të gjitha njësive gjeneruese të Gjeneratorit të Rregulluar.

6 Caku i disponibilitetit i njësisë gjeneruese “i” në muajin “j” do të llogaritet sipas formulës:

$$CID_{ij} = KIG * (24 \cdot DEM_j - DPP_j - DMM_j)$$

Ku

$CID_{ij}$  paraqet Cakun e Disponibilitetit për gjeneratorin “i” në muajin “j”

KIG paraqet kapacitetin e instaluar të Gjeneratorit (matur në MW)

DEM paraqet numrin e ditëve në muajin “j”

DPP paraqet numrin e orëve të vlerësuar të daljeve të paparashikuara të gjeneratorit në muajin “j”


DMM paraqet numrin e orëve në muajin “j” kur gjeneratori pritet të ketë mirëmbajtje të rregullta.

**KREU V**  
**APROVIMI I NGARKESAVE TË RREGULLUARA**

**Përcaktimi dhe aprovimi i ngarkesës për Energji dhe Kapacitet**

- 1 Metodologjia për Përcaktim të Ngarkesave të Gjeneratorit të Rregulluar, dhe çdo amendamentim i propozuar i saj, duhet të dorëzohet për aprovim në Zyrën e Rregullatorit për Energji së paku 30 ditë pune para datës së pritshme të hyrjes në fuqi të saj.
- 2 Metodologjia dhe amendamentimet në të nuk mund të hyjë në fuqi pa aprovim paraprak të Zyrës së Rregullatorit për Energji.
- 3 Gjeneratori i Rregulluar do të ketë të drejtë të përcaktojë Ngarkesat e Rregulluara përderisa ato i përshtaten parimeve të kësaj Metodologjie dhe aprovohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji.
- 4 Për mospajtime me mënyrën e llogaritjes së Ngarkesave të Rregulluara, Gjeneratori i Rregulluar mund të apelojë te Zyra e Rregullatorit për Energji në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.

SHTOJCA 1: Diagrami rrjedhës i llogaritjes së Ngarkesave të Rregulluara



SHTOJCA 2: Tabela e përcaktimit të ngarkesës për kapacitet për Gjeneratorët e Rregulluar

Blloku		Muajt												Total
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Ax	<b>Ditë Pune brenda muajit</b>													
	Nr. i ndaljeve te planifikuara													
	Oret e ndaljeve te planifikuara													
	Nr. i ndaljeve te pa planifikuara													
	Oret e ndaljeve te pa planifikuara													
	Kapaciteti (MW)													
	Orët në Dispozicion													
	<b>Totali i kapacitetit në dispozicion</b>													
Total TC A	<b>Ditë Pune brenda muajit</b>													
	Nr. i ndaljeve te planifikuara													
	Oret e ndaljeve te planifikuara													
	Nr. i ndaljeve te pa planifikuara													
	Oret e ndaljeve te pa planifikuara													
	Kapaciteti (MW)													
	Orët në Dispozicion													
	<b>Totali i kapacitetit në dispozicion</b>													
Bx	<b>Ditë Pune brenda muajit</b>													
	Nr. i ndaljeve te planifikuara													
	Oret e ndaljeve te planifikuara													
	Nr. i ndaljeve te pa planifikuara													
	Oret e ndaljeve te pa planifikuara													
	Kapaciteti (MW)													
	Orët në Dispozicion													
	<b>Totali i kapacitetit në dispozicion</b>													
Tota TC B	<b>Ditë Pune brenda muajit</b>													
	Nr. i ndaljeve te planifikuara													
	Oret e ndaljeve te planifikuara													
	Nr. i ndaljeve te pa planifikuara													
	Oret e ndaljeve te pa planifikuara													
	Kapaciteti (MW)													
	Orët në Dispozicion													
	<b>Totali i kapacitetit në dispozicion</b>													
Total TC A+TCB	<b>Ditë Pune brenda muajit</b>													
	Nr. i ndaljeve te planifikuara													
	Oret e ndaljeve te planifikuara													
	Nr. i ndaljeve te pa planifikuara													
	Oret e ndaljeve te pa planifikuara													
	Kapaciteti (MW)													
	Orët në Dispozicion													
	<b>Totali i kapacitetit në dispozicion</b>													
	<b>Totali i kapacitetit në dispozicion</b>													